



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES KOMEMORATIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS ME
RASTIN E VDEKJES SË KRYETARIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE
TË PRIVATIZIMIT, E MBAJTUR MË 15 QERSHOR 2012**

**SA KOMEMORATIVNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
POVODOM SMRTI PREDSEDNIKA BORDA KOSOVSKE AGENCIJE ZA
PRIVATIZACIJU, ODRŽANE 15 JUNA 2012. GODINE**

**QERSHOR - JUNI
2012**

Mbledhjen komemorative e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
 I nderuar Kabinet qeveritar,
 E nderuara familje Asanaj
 Të nderuar mysafirë,
 Zonja dhe zotërinj,
 E hap mbledhjen komemorative me rastin e vdekjes së Dino Asanajt, kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ju ftoj për një minutë heshtje.

(Mbahet një minutë heshtje)

Nderimi qoftë me të ndjerin!

(Kryetari paraqet fjalë rasti)

KRYETARI: Sot po ndahet prej nesh vëllai dhe miku ynë, Dino Asanaj.

Në jetën e tij të shkurtër, Dino Asanaj bëri aq shumë për të mirën e vendit të vet, për të cilin u përkushtua pa kursim.

Në kushtet e Kosovës së robëruar, Dino i ri, ndonëse i kishte mbaruar studimet profesionale, më 1985 detyrohet t'ia kthejë shpinën atdheut për një jetë më të qetë e të sigurt në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ai me punën, me aftësitë profesionale dhe organizative, me djersën e vet, arriti shpejt të bëhej njëri nga mërgimtarët e suksesshëm në biznes, nëpërmjet kompanisë së themeluar prej tij për projekte banesore dhe komerciale.

Edhe pse larg saj, Dino Asanaj nuk e kishte braktisur as harruar Kosovën e tij të dashur. Krahas punës së palodhshme, me të cilën e mbante familjen e tij, ai u angazhua në veprimtari shoqërore, politike, ushtarake e diplomatike, në shërbim të vendit të vet të robëruar.

Fillimisht, ishte anëtar i Bordit të Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan në Uashington. Dino u mor edhe me publikime të artikujve të shumtë, por edhe të librave, për të vërtetën për Kosovën, për Shqipërinë dhe lëvizjen tonë kombëtare.

Kulmin e angazhimit në karrierën politike, Asanaj e arriti si përfaqësues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të një rëndësie të veçantë kanë qenë veprimet e pareshtura që ai i bëri për afirmimin e luftës sonë çlirimtare në qarqet politike e diplomatike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për përfaqësimin e Kosovës e të interesave të saj, menjëherë pas çlirimit.

Në këtë cilësi, por edhe me përgatitjen e lartë dhe njohuritë që i kishte, Dino Asanaj kontribuoi si këshilltar në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje. Për këtë kontribut madhor, Dino Asanaj është dekoruar me Medaljen e Nderit.

Si njohës i mirë i çështjeve të mërgatës sonë, ai kishte shërbyer edhe si këshilltar i kryeministrit të Kosovës.

Gjithmonë në krye të detyrës, Dino Asanaj u kthye në Kosovë për ta marrë pozitën e kryetarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Dino ishte i ndërgjegjshëm për kompleksitetin e këtij misioni të ri, por njëkohësisht edhe për rëndësinë jetike që ka procesi i privatizimit në fazën e tranzicionit zhvillimor të një vendi të rrënuar ekonomikisht, siç ishte Kosova.

Dino Asanaj ishte një punëtor i madh dhe mik i dashur. Dhe, duhet thënë këtu, që me virtytet e tij të larta, ai kishte shumë miq, të cilëve do t'u mungojë gjatë.

Ai do t'i mungojë edhe Kosovës, për të cilën u angazhua aq shumë dhe aq gjatë.

Duke e përfunduar këtë fjalë, dua t'i ngushëlloj edhe njëherë familjarët e tij, miqtë dhe kolegët për humbjen e Dinos së dashur e të mirë.

I qoftë i lehtë dheu i Kosovës, nënë!

Të nderuar deputetë,

Mysafirë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

Këtu e përfundojmë mbledhjen komemorative, të organizuar me rastin e vdekjes së Dino Asanajt, kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Nderimet bëhen në hollin e Kuvendit.

E përgatiti:

Njësia për Transkript dhe Lekturë